

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Trump: Forca negative duan të ngadalësojnë zhvillimin e Inteligjencës Artificiale
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1391397.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 20:06:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	13 shtator 2026, 19:19:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 13 shtator 2026, 19:18:00 UTC → 13 shtator 2026, 19:20:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d5e5d8ab01882ccff31362d5f3e5353a44a7d05b5f870bda287aedf68f2a716c
TEKSTI	186362edf098459c7c7d7421e8a80f8cf866b9eee86e467a0989e066a68b364e
PAMJA	9fef9ecb233e411fa0a8a7ba4cff8cf1393ca75d5d9ed51af46fbfe539d27faf

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2d31d2c5635299ba20ea0f7e59d7d694d52455d1565e4580757ec2a09b02bd64
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2d31d2c5635299ba20ea0f7e59d7d694d52455d1565e4580757ec2a09b02bd64>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Trump: Forca negative duan të ngadalësojnë zhvillimin e Inteligjencës Artificiale

Shkruar nga: V Gashi | Publikuar më: 13.09.2026, 21:19

 Share

 Share



Presidenti amerikan Donald Trump ka kundërshtuar thirrjet për të ngadalësuar zhvillimin e Inteligjencës Artificiale, duke i cilësuar zërat që ngrënë shqetësime për ritmin e përparimit të teknologjisë si "forca shumë negative".

Trump argumentoi se Shtetet e Bashkuara duhet të ruajnë avantazhin ndaj Kinës në garën për inteligjencën artificiale, duke paralajmëruar se vendosja e kufizimeve të tepërta mund të dëmtojë pozicionin amerikan.

"Ne jemi përpara Kinës dhe dua që të qëndrojmë përpara. Kush fiton garën e AI-së, fiton gjithçka", deklaroi Trump.

Deklaratat e presidentit amerikan vijnë në një moment kur disa prej figurave më të rëndësishme të industrisë së teknologjisë kanë kërkuar një ritëm më të kujdesshëm të zhvillimit.

Dario Amodei, CEO i kompanisë Anthropic, publikoi një propozim për ngadalësimin e ritmit të përmirësimit të modeleve të avancuara të AI, duke argumentuar se masat e sigurisë nuk po arrijnë të ecin me të njëjtin ritëm me aftësitë e reja të sistemeve.

Amodei ka paralajmëruar se, nëse ritmi aktual vazhdon, brenda 6 deri në 12 muaj një grup agentësh të AI me aftësi më të avancuara mund të jetë në gjendje të marrë kontrollin e një pjese të madhe të internetit. Ai e lidhi shqetësimin e tij edhe me një incident të fundit ku agentë të AI u përfshinë në një sulm ndaj platformës Hugging Face.

CEO i Anthropic nuk ka bërë thirrje për ndalimin e zhvillimit të AI, por për një ritëm më të kontrolluar, ndërsa propozon edhe përfshirjen e vlerësuesve të pavarur brenda kompanive të inteligjencës artificiale për të monitoruar sigurinë e sistemeve.

Qëndrimi i Amodei është mbështetur publikisht edhe nga drejtues të tjerë të industrisë, përfshirë CEO-n e OpenAI, Sam Altman, ndërsa debati për balancën mes përparimit teknologjik dhe sigurisë po intensifikohet në SHBA.

Trump, megjithatë, e sheh ngadalësimin e garës si një rrezik strategjik për SHBA-në, veçanërisht përballë Kinës, dhe argumenton se avantazhi amerikan në inteligjencën artificiale duhet të ruhet.

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).



Më të Lexuarat



ARTIKULL JOETIK?

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne!

Marketing

Politika e privatësisë

Rreth Nesh

Kushtet e përdorimit

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.